

**STATUT DHE AKT THEMELIMI**

**I**

**SHOQËRISË TREGTARE**

**“VENIS- Audit & Financë” sh.p.k.**

**Tirane me 01 Gusht 2011**



**STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT  
TE  
SHOQËRISË TREGTARE  
“VENIS- Audit & Financë” sh.p.k.**

**Neni 1**

**Emri i Shoqërisë**

Sot me date 1(një) Gusht 2011, ne ortaket Vera Lala dhe Eni Lala, vendosëm të themelojmë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar që do të mbajë emrin “VENIS- Audit & Financë” sh.p.k.

(Që këtu e më poshtë referuar si “Shoqëria”)

**Neni 2**

**Selia e shoqërisë**

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga: “Fadil Rada”, Pallati “Rruga-Ura”, P.1, Sh.1, Ap.2 (prane ATSH-së), Tiranë.

Shoqëria ka të drejtë të hapë adresa sekondare në të gjithë vendin dhe jasht vendit.

**Neni 3**



**Kohëzgjatja e veprimtarisë**

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jetë e pa kufizuar, duke filluar që prej datës së regjistrimit të saj.

**Neni 4**

**Objekti i veprimtarisë së shoqërisë**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është si vijon:

- 
- 
- a. Shërbime të auditimit ligjor, të dhënies së sigurisë, etj, konform ligjit nr.10091 datë 05.03.2009;
  - b. Shërbime konsulence në fushën e financës, bankës, lizingut, investimeve, tatimeve, etj;
  - c. Shërbime të tjera financiare.
  - d. Çdo aktivitet tjetër që përputhet me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe që konsiderohet nga shoqëria me përfitim dhe i dobishëm për arritjen e objektivave të saj kryesore.

#### Neni 5

Kjo shoqëri mund të ndryshojë emërtimin e saj, selinë, objektin e aktivitetit, të shtojë ortakë, të rrisë kapitalin sipas vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme, në respekt të kërkesave ligjore të parashikuara në ligjin nr. 9901 dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” si dhe në ligjin nr.10091 datë 05.03.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”.

#### Neni 6

##### Kapitali i shoqërisë

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është **500,000 (pesëqind mijë) lekë** dhe është i ndarë në **500 (njëqind) kuota**, me vlerë nominale **1,000 (një mijë) lekë sejcila**.

Kapitali zotërohet si më poshtë:

**-Zj. Vera Fazli Lala**, ekspert kontabel i regjistruar, mbajtes i licencës nr.135, date 27.01.2005 lëshuar nga IEKA, lindur në Tiranë, me datë 08.03.1968, banuese në Rr. “Sotir Kolea”, nr.28/2, Tirane, mbajtëse e kartës së identitetit me Nr. 029126534, e cila zotëron **375 (treqind e shtatëdhjetë e pesë) kuota të kapitalit të shoqërisë ose 375,000 (treqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë**, që përfaqësojnë **75.00 % të kapitalit të nënshkruar**;

**-Z. Eni Sadik Lala**, lindur në Peshkopi, me datë 13.04.1992, banues në Tiranë, Rr. “Sotir Kolea”, nr.28/2, Tirane, mbajtës i kartës së identitetit me Nr. 027181043, i cili zotëron **125 (njëqind e njëzet e pesë) kuota të kapitalit të shoqërisë ose 125,000 (njëqind e njëzet e pesë mijë) lekë**, që përfaqësojnë **25.00 % të kapitalit të nënshkruar**.

Kapitali i shoqërisë është i papaguar. Ortakët do të paguajnë vlerën e kapitalit të nënshkruar në para, deri me datë 31 Gusht 2011.

## Neni 7

Kapitali i shoqërisë mund të shtohet ose të zvogëlohet sipas dispozitave ligjore me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

- (1) Asambleja e Ortakëve mund të rrisë kapitalin e Shoqërisë me anë të një Vendimi të Jashtëzakonshëm.
- (2) Rritja e kapitalit mund të realizohet me anë të përfshirjes së fitimeve apo rezervave në kapital ose me anë të kontributeve të reja.
- (3) Në rast rritjeje të kapitalit të regjistruar me anë të kontributeve të reja në para, këto kontribute të reja në para duhet të nënshkruhen jo më vonë se 3 (tre) muaj pas ditës në të cilën është vendosur rritja e kapitalit. Këto kontribute të reja në para duhet të shlyhen plotësisht jo më vonë se 3 (tre) muaj pas datës së nënshkrimit. Asambleja e Ortakëve mund të përcaktojë afate të tjera kur të vendosë rritjen e kapitalit.
- (4) Në rast rritjeje të kapitalit të regjistruar me anë të kontributeve të reja në natyrë, këto kontribute të reja në natyrë duhet t'i transferohen plotësisht Shoqërisë përpara regjistrimit të rritjes së kapitalit në Regjistrin Tregtar. Vlerësimi i këtyre kontributeve të reja në natyrë do të kryhet në përputhje me parashikimet e Ligjit Tregtar.
- (5) Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në vendimin e asamblesë për rritjen e kapitalit, Ortakët kanë të drejtën e parablerjes për kontributet e reja.
- (6) Asambleja e Përgjithshme mund të zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë me anë të një Vendimi të Jashtëzakonshëm.
- (7) Në rast se zvogëlimi i kapitalit nuk vjen si pasojë e humbjeve financiare apo rasteve të parashikuara në nenet 101 dhe 102 të Ligjit Tregtar, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë që zvogëlimi i kapitalit të përfitohet nga Ortakët në përputhje me kuotat e zotëruara nga secili prej tyre.
- (8) Shoqëria nuk mund të blejë kuotat e veta.

## Neni 8

### Regjistrimi i Shoqërisë

Shoqëria tregtare deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave që përmban ky statut si dhe të legjislacionit shqiptar në fuqi. Ajo konsiderohet e krijuar në datën e regjistrimit në QKR.

## Neni 9

### Kalimi i kuotave

Kuotat e kapitalit të shoqërisë si dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo të kalohen nëpërmjet:

- a- Kontributit në kapitalin e shoqërisë



b- Shitblerjes së kuotave

c- Trashëgimisë

d- Dhurimit

e- Çdo mënyrë tjetër të parashikuar në ligj.



Pjesët e tij ortaku i shoqërisë mund t'ua ofrojë të tretëve të cilët nuk janë ortakë në shoqëri, por gjithmonë duke respektuar të drejtën e parablerjes për ortakët e tjerë të shoqërisë.

Personi që kalon kuotën dhe ai që fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës nga çasti i kalimit të kuotave deri në çastin e regjistrimit të kalimit.

Shoqëria regjistron kalimin e kuotave sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723 datë 13.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

#### **Neni 10**

Emërtimi i shoqërisë tregtare, kapitali themeltar, emri i administratorit duhet të jenë të përmendura në të gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqëri dhe që u drejtohen të tretëve. Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme dhe me përmbajtjen perreth saj.

#### **Neni 11**

##### **Organet e shoqërisë janë:**

- 1- Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë
- 2- Administratori

#### **Neni 12**

##### **Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme**

Asambleja e Përgjithshme e ortakëve ka kompetencat si më poshtë:

- Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- Ndryshimin e statutit;
- Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- Emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;

- Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike.
- Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së nveprimtarisë;
- Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë dhe shperndarjen e fitimit neto;
- Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- Përfaqësimin e shoqërisë në gjyatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

#### Neni 13

Marrja e vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme regjistrohet në regjistrin e vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme, mbajtja e procesverbaleve dhe të gjitha dokumentet e tjera që kanë të bëjnë me të, duhet të bëhen sipas legjislacionit në fuqi për këtë qëllim.

#### Neni 14

Asambleja e Përgjithshme thirret sa herë që është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

Asambleja e Përgjithshme thirret sipas nenit 83, 84 të ligjit 9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose nëpërmjet postës elektronike. 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë. Njoftimi në të dyja format e mësipërme duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës.


#### Neni 15

##### Pjesëmarrja në vendime

Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në vendime si dhe disponon një numër votash të barabartë me pjesët e kapitalit themeltar që ai zotëron.

Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 % të kuotave.

Në rastin kur Asambleja duhet të vendosë për çështje që kërkojnë shumicë të kualifikuar si për shembull: ndryshime në statut, zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit të regjistruar, shpërndarja e fitimeve, riorganizimi dhe shpërndarja e shoqërisë, ajo mund të marrë vendime të vlefshme kur vendos me  $\frac{3}{4}$  e votave të ortakëve pjesëmarrës personalisht ose që votojnë me shkresë apo mjete elektronike.



## Neni 16

### Administrimi

Shoqëria administrohet nga 1 (një) administrator (ose me shume administrator), i cili do të jetë në detyrë për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh me të drejtë riemërimi nëpërmjet vendimit të Asamblesë së Përgjithshme. Në rast se gjatë kësaj periudhe shfaqen probleme paaftësie nga ana e tij, Asambleja e përgjithshme vendos shkarkimin e tij.

Administratori detyrohet të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë duke zbatuar politikat tregtare të vendosura nga asambleja e përgjithshme.

Ai kujdeset për mbajtjen saktë dhe të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë.

Ai përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor të shoqërisë, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet dhe shpërndarjen e fitimeve dhe ia paraqet këto dokumente asamblesë së përgjithshme të ortakëve për miratim.

Ai ka të gjitha kompetencat për të vepruar me të tretët në emër të shoqërisë dhe në interes të saj në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji dhe statuti i shoqërisë ia jep shprehimisht Asamblesë së Përgjithshme.


Administratori ka të drejtë të kryejë vetëm ato veprime të cilat kanë të bëjnë me administrimin e përditshëm dhe të zakonshëm të shoqërisë. Administratori mund të japë prokura tek të tretët brenda kufijve që ligji e lejon dhe në kufijtë që e lejon Asambleja e Përgjithshme e ortakëve për kategori të caktuara veprimesh.

**Administrator i shoqërisë është zj. Vera Lala**, shtetase shqiptare, atësia Fazlli, lindur në Tiranë, më datë 08.06.1968, banues në Tiranë, Rr. "Sotir Kolea", nr.28/2, Tirane, mbajtëse e kartës së identitetit me Nr. 029126534, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

## Neni 17

### Marrëdhëniet e punës

Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës së punës dhe legjislacionit të punës në fuqi. Shoqëria merr persipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të punësuarit janë të detyruar që të respektojnë statutin e kësaj shoqërie dhe rregullat e brendshme të saj. Të punësuarit duhet të përgjigjen për dëmet që i shkaktojnë kësaj shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit. Shpërblimi i Administratorit(ëve) do të përcaktohet sipas parashikimeve të nenit 97 të Ligjit Tregtar.



## Neni 18

### Konfidencialiteti, Ruajtja e sekretit

Konsiderohen konfidenciale dhe nuk lejohet të behen publike përmbajtja e tyre për të tretët e të gjitha akteve dhe dokumenteve që janë përcaktuar si të tilla nga Administratorët e shoqërisë.

## Neni 19

### Viti financiar, pasqyrat financiare, shpërndarja e fitimeve

Viti financiar fillon, më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të sejcilit vit, perjashtimisht nga viti i pare i veprimtarise, i cili fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKR deri me 31 Dhjetor te ketij viti. Administratori merr masat, me qëllim hartimin e pasqyrave financiare, te inventarizimeve vjetore si dhe pergatit raportin per asamblene e ortakeve.

Pas analizes se situates financiare te shoqerise, fitimi neto nga veprimtaria mund te caktohet si vijon:

1. për zmadhimin e kapitalit te regjistruar ose
2. për krijimin e rezervave statutore sipas vendimit qe merr asambleja
3. për tu shperndare si dividend, në raportet qe vendosin ortakët e shoqërisë.

Ndarja e të ardhurave neto do të bëhet nga asambleja e ortakëve sipas aktivitetit të sejcilit prej tyre me miratim të shumicës së ortakëve.

## Neni 20

### Ekspertët kontabël

Asambleja e Pergjitheshme emeron audituesin e pavarur, per auditimin e pasqyrave financiare te shoqerise, sipas parashikimeve të ligjit përkatës.



## Neni 21

### Shpërndarja dhe likuidimi i shoqërisë

Në rast se shoqëria shpërndahet për çdo lloj arsye Asambleja e Përgjithshme përcakton mënyrën e likuidimit, emëron një ose më tepër likuidatorë dhe përgatit të gjitha dokumentet e nevojshme për çregjistrimin e saj.

## Neni 22

### Librat e shoqërisë

Po kështu shoqëria në bazë të ligjit mban librat e mëposhtëm:

- Libri i Asamblesë së Përgjithshme;
- Libri i vendimeve të organit administrativ.

## Neni 23

### Dispozita të përgjithshme

Përsa nuk është shprehur në këtë statut i referohemi ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe ligjit 9723 datë 03.05.2007 “Për QKR”.

Statuti është hartuar në 4 kopje origjinale në gjuhën shqipe.

### Ortakët themelues të shoqërisë “VENIS- Audit & Financë” sh.p.k.

**Vera Fazlli LALA**



**Eni Sadik LALA**



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE  
NR. 35...Rep. 43...Kol

VERTETIM

Sot me date 03.08.2011(dymij e njembedhjete ) ne zyren e Noterise Tirane, perpara meje noteres Pranvera Karafili, u praqiten personalisht:

**Vera Lala** e bija e Fazlliut , lindur ne Tirane ne 8.03.1968, banuese ne Tirane ne Rrugen "Sotir Kolea " Nr 28/2 Tirane , madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar , e cila mbane karte identiteti me Nr 029126534 e njohur personalishte prej meje .

**Eni Lala** I biri I Sadikut , lindur ne Peshkopi me date 13.04.1992 , banues ne Tirane ne adresen e mesiperme , madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar , I identifikuar me karte identiteti NR 027181043. Te cilet nenshkruan Statutin dhe Aktin e Themelimit te Shoqerise Tregtare "VENIS -Audit& Finance "Shpk perpara meje dhe une noteria I konfirmoje nenshkrimin e vene sa me siper , dhe e vertetoj ate sipas ligjit .ia e vertetova sipas ligjit.

NOTERE

*Pranvera Karafili*

*OK*

